



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT K R Y E T A R I

Nr. 1232/18 Prot.

Tiranë, më 04 /05/2017

V E N D I M Nr. 52, Datë 04/05/2017

PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË GRAMSH DHE 9-ISH KOMUNAT KODOVJAT, KUSHOVË, SKENDERBEGAS, KUKUR, POROÇAN, TUNJË, PISHAJ, SULT DHE LENIE "MBI AUDITIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË FINANCIARE".

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësive të Qeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 10,15 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë, vlerësimit financiar dhe menaxhimin e administrimit e aseteve të qëndrueshme”, të ushtruar në Bashkinë Gramsh dhe 9-ish Komunat Kodovjat, Kushovë, Skenderbegas, Kukur, Poroçan, Tunjë, Pishaj, Sult dhe Lenie për periudhën nga data 01.01.2013 deri 31.12.2016.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Bashkia Gramsh në fund të vitit 2016 rezulton debitor në vlerën **82 milion lekë për fatura të pa likuiduara**, nga të cilat 13 milion lekë nga FSHZH për 3 objekte investimesh të përfunduara “Ndërtim ure Poroçan”, “KUZ Cekine” dhe “Rikonstruksion rruge fshati Bersnik”, ndërsa 69 milion lekë nga Bashkia Gramsh dhe ish-komunat.

1.1. Rekomandim: Bashkia Gramsh (Drejtoria Financë Buxhetit) në mbledhjen e këshillit bashkiak të analizojë gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartoj një grafik për likuidimin e tyre, duke zbatuar radhën e pagesave për likuidimin e detyrimeve të

prapambetura për vlerën 82 milion lekë.

Brenda vitit 2017

2. Gjetje nga auditimi: Bashkia Gramsh për vitet 2011-2015 rezulton debitor në vlerën **21 milion lekë**, detyrim i lindur nga **19 procese gjyqësore** të fituara me vendim të formës së prerë nga ish-nëpunës për largim të padrejtë nga puna dhe në 1 rast nga subjekt sipërmarrës në fushën e shërbimeve. Largimi i padrejtë nga puna ka sjellë pagesë të dyfishtë për të njëjtin vend pune duke shkaktuar efekt financiar negativ në buxhetin e Bashkisë, për të cilën nuk ka dalë përgjegjësia, në kundërshtim me pikën 62 të UMF nr. 2 datë 6.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

2.1. Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masa dhe të nxjerrë përgjegjësitë ndaj personave përgjegjës për detyrimin në vlerën 21 milion lekë, i krijuar nga 19 procese gjyqësore të fituara me vendim të formës së prerë nga ish-nëpunës për largim të padrejtë nga puna dhe në 1 rast nga subjekt sipërmarrës në fushën e shërbimeve. Njëherazi të marrë masa për likuidimin e vlerës 5 milion lekë të mbetur pa likuiduar në fund të vitit 2016.

Brenda vitit 2017

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i shpenzimeve të pastrimit të qytetit me sipërmarrje private, për vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016, u konstatua se planifikimi dhe realizimi i tyre paraqitet i fryrë në disa zëra mbështetur dhe në verifikimet e kryera në terren. Kostoja e pastrimit është në raport të zhdrejtë me të ardhurat e tarifës së pastrimit e cila mbulon 50% të këtij shërbimi.

3.1. Rekomandim: Bashkia Gramsh, me miratim të KB, të rishikoj dhe reduktoj koston e shpenzimeve për pastrimin në përputhje me të ardhurat e kësaj tarife, ose në të kundërt të vlerësoj mundësinë e kalimit të këtij shërbimi nën administrimin e Bashkisë duke rritur eficientën dhe efektivitetin e të ardhurave të krijuara nga taksa pastrimit.

Brenda vitit 2017

4. Gjetje nga auditimi: Bashkia Gramsh nuk i ka shfrytëzuar disa mjete, si autovetura dhe fadroma të ish-komunave, por është mjaftuar me mbylljen e tyre në ambientet e uzinës së baterive, pasi ato janë të amortizuara dhe me defekte, pavarësisht se ato janë riparuar dhe furnizuar me karburant deri në periudhën e shkrirjes së komunave korrik 2015, e cila ka shkaktuar mungesë efience të përdorimit të fondeve publike, në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

4.1. Rekomandim: Bashkia Gramsh të shikojë mundësinë e riaktivizimit të mjeteve, si autovetura dhe fadroma të ish-komunave, brenda limitit ligjor të shpenzimeve, për efekt të shfrytëzimit të tyre për nevojat e Bashkisë, në të kundërt të fillojnë procedurat ligjore të nxjerrjes në ankand të këtyre mjeteve.

Brenda vitit 2017

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i **taksave vendore** të Bashkisë Gramsh për vitin 2013-2016, u konstatua:

-Për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore nuk disponohet projektvendim i studiuar për përlogaritjen e saktë të çdo takse e tarifë vendore mbi bazën e të dhënave konkrete.

-Disa subjekte kanë mospërputhje të pagesës së taksës të ndërtesës me sipërfaqen e ndërtesës sipas certifikatës të pronësisë.

-Nuk kanë shlyer taksat vendore disa punonjës dhe këshilltar të Bashkisë Gramsh për vlerën 125,665 lekë dhe nuk është bërë ndalesa e tyre në borderot përkatëse.

-Debitorët e taksave vendore për Bashkinë Gramsh pa njësitë administrative, deri më datë 31.12.2016, paraqiten për vlerën 2,433,419 lekë, nga kjo: biznesi i vogël 1,017,049 lekë dhe

biznesi i madh 1,416,370 lekë.

-Debitorët e taksave vendore për Njësitë Administrative deri më datë 31.12.2016, paraqiten sa vijon: NJA Kodovjat 1,237,120 lekë për 20 subjekte; NJA Pishaj 276,836 lekë për 9 subjekte; NJA Kushovë 305,332 lekë dhe NJA Skënderbegas 585,100 lekë. Njësitë Administrative Lenie, Porocan, Kukur, Sult dhe Tunjë nuk kanë vënë në dispozicion të dhënat.

-Subjekti “.....” shpk nuk ka paguar detyrimet vendore në vlerën 207,900 lekë pranë njësisë Lenie dhe S.C. 121,400 lekë takse qiraje HEC Banje.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 ndryshuar me ligjin nr. 142, datë 17.12.2015 “Për sistemin e taksave vendore”, dhe ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”.

5.1. Rekomandim: Drejtoria e taksave vendore e Bashkisë Gramsh të marrë masa:

-Për planifikimin dhe përllogaritjen e saktë të çdo takse e tarifë vendore, mbi bazën e të dhënave konkrete dhe dokumenteve përkatëse.

-Për arkëtimin e vlerës **2,433,419 lekë** ndaj debitorëve të taksave vendore për Bashkinë Gramsh.

-Për arkëtimin e vlerës **125,665 lekë** taksave vendore të pa paguara nga disa punonjës dhe këshilltar të Bashkisë Gramsh.

-Për arkëtimin e debitorëve të taksave vendore të njësive administrative, përkatësisht: NJA **Kodovjat 1,237,120 lekë**, NJA **Pishaj 276,836 lekë**, NJA **Kushovë 305,332 lekë**, NJA **Skënderbegas 585,100 lekë** (sipas listave në raportin përfundimtar të auditimit). Ndërsa për NJA Lenie, Porocan, Kukur, Sult, Tunjë, të cilat nuk kanë paraqitur të dhëna për debitorët e taksave vendore, të ndiqet arkëtimi i tyre, sipas listës të njësive administrative.

-Subjekti fizik S. C. të shlyej detyrimin **121,400 lekë**, për objektin zyra të marra me qira nga punonjësit e hidrocentralit Banjës me sipërfaqe 607 m².

-Subjekti “P...” shpk të shlyej detyrimet vendore në vlerën **207,900 lekë**.

Brenda muajit Shtator 2017

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i IMTV (Inspektoriatit Mbrojtjes Territorit Vendor) të Bashkisë Gramsh, u konstatua se IMTV nuk ka arkëtuar gjobat e për ndërtimet pa leje, sipas shkresës nr. 6940, datë 21.10.2016 për vlerën **1,357,000 lekë** ndaj 12 subjekteve. IMTV nuk ka vendosur sanksione për 55 ndërtime pa leje, për periudhën nëntor 2013-dhjetor 2016, pasi vendimet e pezullimit nuk janë shoqëruar me vendime prishje, gjoja dhe kallëzime penale në kundërshtim me nenin 75 të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën” dhe me nenin 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit”, me nenin 15/a të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, ndryshuar.

6.1. Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masa për arkëtimin e vlerës **1,357,000 lekë** për 12 subjekte. IMTV të marrë masa për prishjen e ndërtimeve pa leje, përfshirë dhe objektin e ankimuar nga një qytetar, duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore të parashikuara nga aktet ligjore dhe nënligjore të fushës (sipas pasqyrës në projektraportin e auditimit).

Brenda vitit 2017

7. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2013-2014 në Bashkinë Gramsh në bazë të kërkesave të hartuara nga Sektori i Kulturës janë kryer pagesa në 19 raste në shumën 990,570 lekë për shpenzime për organizime e realizim të aktiviteteve social-kulturore në kundërshtim me VKM nr. 1173, datë 6.11.2009 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura” pika 2, me VKM nr.243 datë 15.05.1995 “Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja” të ndryshuar me VKM nr.258 datë 3.6.1999.

7.1. Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masa, nëpërmjet Sektorit të Kulturës dhe Sportit, për organizimin dhe realizimin e aktiviteteve social-kulturore dhe të folklorit të bëhen në bazë të projekteve, ndërsa aktivitetet kulturore apo festive me pjesëmarrës profesionist të kryhen me procedura prokurimi.

Në Vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagesave për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, u konstatuan pagesa:

-**Bashkia Gramsh** 3,845,530 lekë për 28 raste në vitin 2013 dhe 5,069,259 për 43 raste lekë në vitin 2014.

-**Ish-komuna Kodovjat** 2,505,729 lekë për 19 raste në vitin 2013, 799,560 lekë për 3 raste në vitin 2014 dhe 1,233,300 lekë për 7 raste në 6-mujorin e parë të vitit 2015.

-**Ish-Komuna Poroçan** 2,400,591 lekë për 18 raste në vitin 2013, 1,531,999 për 13 raste në vitin 2014 dhe 1,170,530 lekë për 10 raste në 6-mujorin e parë të vitit 2015.

- **Ish-komuna Tunjë** 2,487,901 lekë për 17 raste në vitin 2013 në vlerën, 875,200 lekë për 8 raste në vitin 2014 në vlerën dhe 1,240,334 lekë për 5 raste në 6-mujorin e parë të vitit 2015.

U konstatuan mangësi dhe parregullsi në plotësimin e dokumentacionit pjesë e dosjes së procedurave të blerjeve me vlera të vogla si: nuk ka argumentim të nevojës së blerjes të mallit apo shërbimit, nuk ka argumentim të fondit limit nëpërmjet dokumentimit të testimit të tregut, mungon raporti përmbledhës i procedurës së miratuar nga Kryetari i AK, nuk është bërë shkarkimi nga sistemi elektronik i menysë së mesazheve në mbështetje të klasifikimit të ri ofertave, nuk ka paraqitje nga OE fitues të dokumenteve të kërkuar (si vërtetimet për detyrime, QKR, leje etj), mungon akti i marrjes në dorëzim i mallit apo shërbimit, veprime këto në kundërshtim me UMF nr. 33 datë 11.07.2013 dhe nr. 57 datë 12.06.2014 “Për Gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë” tabela1/3 dhe me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik” pika 37, 42, 43 dhe 44.

8.1. Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masa për vendosjen e rregullave për hartimin e gjurmës standarde të prokurimit të blerjeve me vlera të vogla, ku të përcaktohet procesi i punës, që nga hartimi i kërkesave e përcaktimit të nevojave, përlllogaritjes së vlerës limit të kontratës deri në përfundimin e procedurës së prokurimit mbi bazën e dokumenteve të plota ligjore financiare justifikues, autorizues dhe vërtetues.

Në Vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga **ish-Komuna Tunjë** me urdhër-shpenzimi nr. 79 datë 29.04.2014 është bërë pagesë në shumën 408,000 lekë OE “A...” shpk për blerjen e një mjeti transporti vetëshkarkues 3 ton në bazë të Urdhër Prokurimit nr. 4 datë 07.04.2014 dhe faturës nr. 222 datë 24.04.2014. Në ftesën për ofertë nuk janë përcaktuar në kriteret e veçanta të kualifikimit specififikimet teknike dhe dokumentet që duhet të paraqiten. Në praktikën e blerjes mungon kontrata e noterizuar e shit-blerjes, mungon certifikata e automjetit në pronësi të Ish-Komunës Tunjë, automjeti figuron me dokumente në pronësi të shitësit. Nuk është bërë hyrje në magazine dhe dalje nga magazina i këtij mjeti me kartelë individuale personit përgjegjës që e ka në përdorim me qëllim ruajtjen e mjetit, pavarësisht se mjeti i ka kaluar Bashkisë Gramsh, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Kreu i VI pikës 2/a, nenin 826 me ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë” dhe me pikat 37, 42, 43 dhe 44 të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”.

9.1.Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masa dhe plotësojë dokumentacionin e nevojshëm të automjetit vetëshkarkues 3 ton me targë GR 1349B, në mënyrë që të bëjë

regjistrimin e këtij mjeti në pronësi të Bashkisë dhe të marrë certifikatën përkatëse dhe të pajisë mjetin me leje qarkullimi.

Në Vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2015-2016 arkëtimi i qirave të truallit nga kontratat e lidhura nga Bashkia Gramsh është bërë në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Elbasan, ndërkohë që kontratat janë lidhur nga Bashkia Gramsh, e cila nuk ka arkëtuar nga DRT asnjë të ardhur në lidhje me qiratë e arkëtuara dhe nuk ka asnjë rakordim apo informacion për realizimin e kësaj lloji të ardhure, duke shkaktuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Gramsh në shumën 3,152,712 lekë.

10.1.Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masat, që të vendosë korrespondencë zyrtare me DRT Elbasan për arkëtimet e qirave nga personat që kanë lidhur kontrata qiraje për truallin me Bashkinë Gramsh, e ardhur e cila i takon kësaj njësie vendore.

Brenda muajit Qershor 2017

11. Gjetje nga auditimi: Nga ish-komunat Porocan dhe Lenie nuk janë lidhur kontrata për qiradhënie të parcelave nga fondi pyjor-kullosor, prona të miratuara me VKM, për përdorimin e tyre nga Shoqëria HEC-Poroçan e subjektit “M...” të sipërfaqes prej 1.2ha dhe Shoqëria HEC-Lenie e subjektit “...” me sipërfaqe 0.145 ha. Nga ish-komuna Porocan është bërë arkëtimi i qirasë pa lidhur kontratë, ndërsa nga ish-komuna Lenie nuk është kryer arkëtim qiraje veprime këto në kundërshtim me nenin 11, pika 4,5 dhe nenin 12 pika f dhe g të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, të cilat kanë shkaktuar të ardhura e munguara në buxhetin e ish-Komunës Lenie në vlerën 254,200 lekë.

11.1.Rekomandim: Bashkia Gramsh, me qëllim rritjen e të ardhurave, të marrë masat për lidhjen e kontratave të qiradhënies me shoqëritë HEC- Poroçan e subjektit “S...” dhe Shoqërinë HEC- Lenie e subjektit “S...” të cilët përdorin parcela nga fondi pyjor-kullosor pronë të Njësi Administrative Lenie dhe Porocan.

Në Vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Ish-Komunat Skënderbegas, Sult, Kushovë, Kukur, Lenie dhe Kodovjat, të përthithura nga Bashkia Gramsh, për periudhën 2008-2013 kanë lidhur 66 kontrata për dhënie me qira të 118.2 ha nga fondi i tokave të pandara, për përdorim për ullishte, vreshta, bime medicinale, bime are, mollë, arra, lajthi, kumbull, qershi. Nga këto 42 kontrata janë me afat 99 vjet, 5 kontrata me afat 30-35 vjet, 18 kontrata me afat 9-10 vjet dhe 1 kontratë me afat 49 vjet. Në të gjitha rastet dhënia me qira e tokave bujqësore të pandara është bërë vetëm me Vendim të KQTBP, pa u miratuar në Këshillin të Komunës në kundërshtim me nenin 32/ë ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore ndryshuar. Kontratat e qirave me afat mbi 9-vjet nuk janë lidhur me akt noterial nga ish-Komuna Kushovë në 1 rast, ish-komuna Kukur në 2 raste, ish-komuna Lenie në 12 raste, ish-Komuna Kodovjat në 29 raste. Në të gjitha rastet e kontratave me afat mbi 9-vjet, të lidhura nga ish-Komunat Kushovë, Kukur, Lenie dhe Kodovjat nuk janë regjistruar në ZVRPP veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë” neni 826 dhe UKM nr. 3, datë 16.5.2007 dhe UKM nr.1, datë 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara” pika 11.

12.1. Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masat të rishikojë kontratat e qiradhënies të lidhura nga ish-komunat me fermerët nga fondi i tokave të pandara, të bëjë përmirësimet e nevojshme aty ku është e mundur në marrëveshje me palët, pasi të ketë bërë verifikimet në terren për të dhënat e parcelave dhe plotësimin e kushteve të kontratave si dhe të bëjë noterizimin dhe regjistrimin e tyre në ZVRPP Gramsh.

Brenda muajit Shtator 2017

13. Gjetje nga auditimi: Nga ish-Komuna Kodovjat është lidhur kontrata pa nr, datë 01.07.2013 me subjektin privat z. F. Ç., me afat 10 vjet me objekt: “Dhënie në përdorim të një sipërfaqeje pyjore prej 0.455 ha në zonën kadastrale nr. 2167. Nga verifikimi i këtyre të dhënave në listën e pronave pyje dhe kullota të kaluara kësaj njësie vendore, me VKM nr. 683 datë 21.05.2008, rezulton se këto parcela pyjore nuk përfshiheshin, dhe zona kadastrale 2167 i korrespondon fshatit Koçaj të ish-Komunës Pishaj. Objekti i kësaj kontrate nuk është parcelë në pronësi apo përdorim të komunës. Në dhënien me qira të kësaj pasurie nuk janë zbatuar rregullat dhe procedurat e përcaktuara në nenet 19, 23.7 dhe 26.10, ligjin nr. 9385 datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" të ndryshuar, me ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullor", të ndryshuar, me pikat 6 dhe 16 të VKM nr. 22, date 9.1.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të administrimit të pyllit komunal”, me pikat 10-12 të UKM nr. 4, datë 22.4.2013 “Për përcaktimin e kriterëve të konkurrimit dhe procedurën e dhënies në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullor publik”.

13.1. Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masa për rishikimin kontratës së qirasë të lidhur midis ish-komunës Kodovjat dhe z. F. Ç. e lidhur në kundërshtim me nenet 19, 23.7 dhe 26.10, ligjin nr. 9385 datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" të ndryshuar, me ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullor", të ndryshuar, me pikat 6 dhe 16 të VKM nr. 22, date 9.1.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të administrimit të pyllit komunal”, me pikat 10-12 të UKM nr. 4, datë 22.4.2013 “Për përcaktimin e kriterëve të konkurrimit dhe procedurën e dhënies në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullor publik”.

Brenda muajit Qershor 2017

14. Gjetje nga auditimi: Nga ish-Komuna Kodovjat është lidhur kontrata me personat V. B. dhe N. Rr. datë 28.06.2013 me afat me 99-vjeçar me objekt: *Dhënia me qira për mbjelljen “kulture ulliri” të pasurisë tokë bujqësore (arë) në parcelën 35/3 në zonën kadastrale 2607 me sipërfaqe 54420 m².* Kjo ngastër para se të jepej me qira ka qenë ngastër e llojit të pasurisë “pyll trungishte” prodhues me numër ngastre 2/a, e cila është kthyer në tokë “arë” me Vendimin nr. 1 datë 15.04.2013 nga KQTBP. Nga verifikimi në listën e pronave të miratuara me VKM e viteve 2008 dhe 2012 rezulton se *ngastra nga fondi pyjor-kullor me nr. 2/a nuk është përfshirë në këtë listë.* Më datë 10.04.2013 ka dalë Certifikata për vërtetim pronësie e ZVRPP Gramsh për pasurinë 35/3 e llojit “arë” sipërfaqe totale 54420 m². Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 23 të ligjit nr. 9385, datë 04.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" të ndryshuar.

14.1.Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masa për rishikimin e kontratës të lidhur nga ish-Komuna Kodovjat me V. B. dhe N.RR. me aktin noterial nr. 683 Rep., nr. 273 Kol., datë 28.06.2013 në kundërshtim me nenin 23 të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" të ndryshuar

Brenda muajit Qershor 2017

15. Gjetje nga auditimi: Nga 9 ish-Komunat e përthithura nga Bashkia Gramsh është lejuar zaptimi dhe përdorimi i pasurive në pronësi të Komunave nga të tretë pa pasur tagër ligjore (*pronësie apo qiraje*), duke shkaktuar të ardhura të munguara për buxhetin e ish-komunave, nga shfrytëzimi i të tretëve i këtyre objekteve, në kundërshtim me nenet 11/4 dhe 12/f të ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe kap III, pika 26,30 e UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

15.1.Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masa dhe të lidhë kontrata qiraje me personat

që shfrytëzojnë pronat e ish-komunave pjesë të Bashkisë, të administruara nëpërmjet Njësive Administrative, duke ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

Brenda vitit 2017

16. Gjetje nga auditimi: Bashkia Gramsh nuk ka zbatuar rekomandimet e auditimeve të mëparshme për shpërblimin e dëmit në vlerën **13,011,806 lekë**, të përcjella me anë të shkresës nr. 572/14, datë 28.09.2012 dhe procesverbalit datë 6.6.2013 të KLSH.

16.1.Rekomandim: Bashkia Gramsh të ndjekë të gjitha hapat ligjore për zbatimin e rekomandimeve të KLSH për vlerën **13,011,806 lekë** (sipas pasqyrave të raportit të auditimit).

Brenda muajit Shtator 2017

B/1. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Mbështetur në nenet 98-102 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenet 21-33 të ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pika 93 e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e titullarit të njësisë publike, (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare me qëllim për shpërblimin e dëmit në vlerën në vlerën **64,449,187 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i shpenzimeve të kryera nga **Bashkia Gramsh** për vitin 2015-2016 u konstatuan shkelje ligjore në vlerën **580,460 lekë dëm ekonomik**, konkretisht:

-vlera **305,000 lekë**, shpenzime të paligjshme për pritje-përcjellje (drekë), sipas urdhër shpenzimit nr. 136, datë 17.03.2015, në kundërshtim me VKM nr. 243, datë 15.05.1995 “Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja” të ndryshuar me VKM nr. 258, datë 3.6.1999.

-vlera **274,200 lekë**, për subjektin Xh. M., sipas urdhër shpenzimit nr. 383, datë 14.07.2015, për mirëmbajtjen e godinës të gjimnazit “Shefqet Guzi” Gramsh, pasi shpenzimi nuk justifikohet dhe është i dubluar në kundërshtim me udhëzimin e APP nr. 2, datë 28.3.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik.

1.1.Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës **580,460 lekë**, përkatësisht:

-vlerën **274,200 lekë**, ndaj subjektit Xh. M.,

-vlerën **305,000 lekë**, ndaj personave të listës bashkëlidhur urdhër shpenzimit nr. 136, datë 17.03.2015.

Brenda muajit Shtator 2017

2. Gjetje nga auditimi: Bashkia Gramsh nuk ka lidhur kontratë dhe nuk ka arkëtuar *taksën për truallin* për 4 subjekte TEC dhe Hidro në kundërshtim me pikën “2/c” të paketës fiskale 2016 miratuar me VKB nr. 72, date 21.12.2015 dhe nr. 2. date 25.01.2016 dhe neni 23/1 pika 1 dhe 2 e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin taksave vendore” i ndryshuar, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën **19,508,124 lekë**, konkretisht:

a. subjekti "D..." nuk ka paguar taksën për truallin për periudhën tetor-dhjetor 2016 në vlerën 19,470,000 lekë.

b. Subjekti "E..." nuk ka paguar taksën për truallin për vitin 2016 në vlerën 14,400 lekë.

c. Subjekti "H..." nuk ka paguar taksën për truallin për vitin 2016 në vlerën 8,184 lekë.

d. Subjekti "M.O" nuk ka paguar taksën për truallin për vitin 2016 në vlerën 15,540 lekë.

2.1.Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masa dhe të lidh kontratat qiraje për vitin 2017 me 4 subjekte TEC dhe Hidro që përdorin truallin në territorin e Bashkisë Gramsh. Drejtoria e Taksave bazuar në nenet 70 pika 3, 90, 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore në R.SH" i ndryshuar, të nxjerr njoftim vlerësimet tatimore në vlerën **19,508,124 lekë** për 4 subjekte TEC dhe Hidro, përkatësisht:

- për vlerën 19,470,000 lekë ndaj subjekti "D...";

- për vlerën 14,400 lekë ndaj subjekti "E...";

- për vlerën 8,184 lekë ndaj subjekti "H...";

- për vlerën 15,540 lekë ndaj subjektit "M.O".

Brenda vitit 2017

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ish-Komunës Sult u konstatuan shkelje me efekte financiare në vlerën **261,600 lekë dëm ekonomik**, sa vijon:

a. vlera **119,900 lekë** shpenzimet celulare, përfituar nga kryetari i komunës Sult, sipas urdhër shpenzimeve nr. 159, datë 11.2014 dhe nr. 175/1, datë 24.12.2013, në kundërshtim me pikën 9 të VKM nr. 864, datë 23.07.2010 "Për pajisjen me numër telefoni celularë të personave juridikë, publikë".

b. vlera **52,500 lekë**, përfituar dieta të pa justifikuar, në linjën komuna Sult-Tiranë, përkatësisht nga K. C. 40,000 lekë dhe V. D. 12,500 lekë, sipas urdhër shpenzimit nr. 50, datë 11.4.2014 në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjëset që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës".

c. vlera **89,200 lekë**, shpenzim i pajustificuar, pasi janë blerë 40 m³ dru zjarri në kohë të ngrohtë pranvere, sipas urdhër shpenzimit nr. 30, datë 22.4.2015, faturës së subjektit nr. 13, datë 10.4.2015, fletëhyrjes komunës nr. 3, datë 10.4.2015, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

3.1.Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës **261,600 lekë**, përkatësisht:

a. vlerën **119,900 lekë**, ndaj z. K. C.;

b. vlerën **52,500 lekë**, ndaj K. C. në shumën 40,000 lekë dhe ndaj V. D. në shumën 12,500 lekë;

c. vlera **89,200 lekë**, ndaj kryetarit të komunës, financierit dhe komisionit të blerjeve të vogla.

Brenda muajit Korrik 2017

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ish-Komunës Skënderbegas u konstatuan shkelje me efekte financiare në vlerën **962,400 lekë dëm ekonomik**, konkretisht:

a. vlera **60,000 lekë**, për diferencë çmimi të artikullit dërrasë e stazhionuar, për "rikonstruksionin e urës përroi i Trepes Siman", pasi komuna i ka blerë 2-fish më shtrenjtë të njëjtin material brenda të njëjtës periudhe (dhjetor 2014) tek i njëjti subjekt "T...", sipas faturës nr. 31, datë 18.12.2014 me çmimin 30,000 leke/m³ dhe nr. 24, datë 10.12.2014 me çmimin 15,000 leke/m³, në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

b. vlera **346,800 lekë**, për dublim shpenzimi, për "Rikonstruksion ujësjellësi në fshatin Bletëz" të kryera nga subjekti "M...", sipas urdhër shpenzimit nr. 98, datë 9.7.2014 dhe nr.

127 datë 22.6.2015, pasi rikonstruksioni i këtij objekti është kryer 4 herë më parë po nga ky subjekt, në harkun kohor 2 vjeçar, sipas urdhër-shpenzimeve nr. 117 datë 27.8.2013, nr. 145 datë 24.10.2013, nr. 117, datë 21.7.2014 dhe nr. 118 date 21.7.2014, nr. 201, datë 10.12.2014, në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

c. vlera **81,000 lekë**, për shpërblim të paligjshëm të punonjësit e administratës së ish-komunës me rastin e vitit të ri 2013, sipas urdhër shpenzimit nr. 2, datë 9.01.2013, përkatësisht: H. P., H. M., A. H., Ç. Ç., K. Z., G. P., V. H., F. Zh., N. Z., me nga 9,000 lekë për secilin, në kundërshtim me pikën 1/b të VKM nr. 472, datë 02.7.2011”Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore”, me pikën 5 të VKM nr. 589, datë 5.9.2012 ”Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2012” dhe VKM datë 10.7.2013.

d. vlera **80,000 lekë**, shpenzime pritje përcjellje, sipas urdhër shpenzimit nr. 225, datë 24.12.2014, për 70-vjetorin e çlirimit atdheut me pjesëmarrjen e 180 vetave, rezulton se: shpenzimi nuk është i justifikuar, pasi nuk ka mbështetje ligjore dhe paraqet mangësi dokumentare, pasi nuk ka miratim në Këshillin Komunës, program festiv dhe listë të miratuar për 180 veta, në kundërshtim me VKM nr. 243, datë 15.05.1995 “Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja” të ndryshuar me VKM nr. 258, datë 3.6.1999.

e. vlera **260,000 lekë**, për dieta të përfituara tepër, në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjëset që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit”, sipas urdhër shpenzimit nr. 21, datë 16.3.2015, nr. 38, datë 13.3.2014, nr. 145, datë 9.9.2014, nr. 211, datë 15.12.2014, nr. 47, datë 26.3.2013.

k. vlera **61,000 lekë**, për shpenzimet celulare, përfituar nga kryetari i Komunës Skënderbegas z. H. P., për vitin 2013, 2014 dhe 2015, në kundërshtim me VKM nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celularë të personave juridikë, publikë”, pika 9, sipas urdhër shpenzimeve nr. 30, datë 20.3.2015 dhe nr. 35, datë 12.3.2014.

l. vlera **73,600 lekë**, për tvsh përfituar 2 herë, nga subjekti “...”, sipas urdhër shpenzimeve nr. 60 datë 21.4.2014, nr. 74 date 20.5.2014 etj, për “Rikonstruksionin e shkollës mesme Skënderbegas 2013”, pasi në preventivin dhe situacionin përfundimtar zëri “Makineri dhe Pajisje ” subjekti i ka llogaritur me gjithë vlerën e tvsh, në mospërputhje me UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, nuk është ndarë veças vlera e “montimit” të pajisjeve pa tvsh dhe veças vlera e “pajisjeve” me gjithë vlerën e tvsh dhe vihet në fund të situacionit, për rrjedhojë është përfituar padrejtësisht.

4.1. Rekomandimi: Bashkia Gramsh të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës **962,400 lekë dëm ekonomik**, përkatësisht:

a. vlerën **60,000 lekë**, nga 15,000 lekë secili, ndaj: H. P., A. H., Ç. Ç. dhe K. Z..

b. vlerën **346,800 lekë**, nga 86,700 lekë secili, ndaj: H. P., A. H., Ç. Ç. dhe K. Z..

c. vlerën **81,000 lekë**, me nga 9,000 lekë për secili, ndaj: H. P., H. M., A. H., Ç. Ç., K. Z., G. P., V. H., F. Zh., N. Z.,

d. vlerën **80,000 lekë**, ndaj 180 veta, sipas listës bashkëngjitur urdhër shpenzimit nr. 225, datë 24.12.2014,

e. vlerën **260,000 lekë**, përkatësisht: H. P. 102,500 lekë, A. H. 85,000 lekë, Ç. Ç. 12,500 lekë, H. M. 20,000 lekë, K. Z. 12,500 lekë, F. Zh. 7,500 lekë dhe V. H. 20,000 lekë.

k. vlerën **61,000 lekë**, ndaj H. P..

l. vlera **73,600 lekë**, ndaj subjektit “N...”.

Brenda muajit Gusht 2017

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ish-Komunës Kushovë u konstatuan shkelje me

efekte financiare në vlerën **327,500 lekë dëm ekonomik**, konkretisht:

a. vlera **54,000 lekë**, për shpërblim të paligjshëm, për 6 punonjësit e administratës së ish-komunës me rastin e vitit të ri 2013, sipas urdhër shpenzimit nr. 2, datë 11.01.2013 dhe borderove të muajit dhjetor 2012 në kundërshtim me pikën 1/b të VKM nr. 472, datë 02.7.2011 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore”, me pikën 5 të VKM nr. 589, datë 5.9.2012 “Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2012”.

b. vlera **31,500 lekë**, për shpërblim tepër këshilltarin N. Z., pasi ka marrë dyfish shpërblim më shumë se këshilltarët tjerë për periudhën janar 2015-qershor 2015, sipas urdhër shpenzimeve nr. 14, datë 10.03.2015, nr. 43, datë 14.05.2015, nr. 60, datë 3.06.2015, nr. 71, datë 3.07.2015.

c. vlera **120,000 lekë**, për shpenzimet celulare, për kryetarin e Komunës z. Xh. B. për vitin 2013, 2014 dhe 2015, pasi i ka përfituar në kundërshtim me VKM nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celularë të personave juridikë, publikë”, pika 9, konkretisht sipas urdhër shpenzimit nr. 55, datë 7.5.2013 dhe nr. 56, datë 15.4.2014.

d. vlera **70,000 lekë**, për pritje dhe përcjellje, sipas urdhër shpenzimit nr. 131, datë 4.11.2014 është shpenzuar për një drekë, me pjesëmarrjen e 58 vetave me nga 1,207 lekë/secili, në kundërshtim me VKM nr. 243, datë 15.05.1995 “Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja” të ndryshuar me VKM nr. 258, datë 3.6.1999.

e. Sipas urdhër shpenzimeve nr. 193 datë 26.11.2014 etj për “Rikonstrukcion i shkollës 9-vjeçare Sotire” ish-Komunën Kushovë, rezultoi vlera **52,000 lekë tvsh** përfituar padrejtësisht nga subjekti juridik “B...” shpk (262,800 lekë x20%), pasi në preventiv dhe situacionin përfundimtar zëri “Makineri dhe Pajisje” subjekti i ka llogaritur me gjithë vlerën e tvsh, në mospërputhje me UKM nr. 2, datë 08.05.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, nuk është ndarë veças vlera e “montimit” të pajisjeve pa tvsh dhe veças vlera e “pajisjeve” me gjithë vlerën e tvsh dhe vihet në fund të situacionit.

5.1. Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës **327,500 lekë dëm ekonomik**, përkatësisht:

a. vlerën **54,000 lekë**, ndaj: Xh. B. 9,000 lekë, F. B. 9,000 lekë, F. M. 9,000 lekë, E. F. 9,000 lekë, F. D. 9,000 lekë dhe L. Z. 9,000 lekë.

b. vlerën **31,500 lekë**, ndaj N. Z.

c. vlerën **120,000 lekë**, ndaj Xh. B.

d. vlerën **70,000 lekë**, për 58 persona nga 1,207 lekë/secili.

e. vlerën **52,000 lekë** ndaj subjektit “B...”.

Brenda muajit Korrik 2017

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ish-Komunës Kukur u konstatuan shkelje me efekte financiare në vlerën **3,896,889 lekë dëm ekonomik**, sa vijon:

a. vlera **252,100 lekë**, sipas urdhër shpenzimit nr. 29, datë 15.3.2013, në kundërshtim me VKM nr. 243, datë 15.05.1995 “Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja” të ndryshuar me VKM nr. 258, datë 3.6.1999.

b. vlera **111,173 lekë**, shpenzim i pa justifikuar, sipas urdhër shpenzimit nr. 14/1, datë 25.01.2013 për subjektin “...”.

c. vlera **945,597 lekë**, shpenzim i pajustificuar, sipas urdhër shpenzimeve nr. 29, datë 11.3.2015, nr. 35, datë 18.3.2015, nr. 95, datë 26.6.2015. Punimet paraqiten të dubluara, pasi mirëmbajtja, pastrimi, transporti i zhavorrit, heqja e zhvendosja e dheut, mbushja e gropave të rrugëve të komunës është kryer nga persona privat sipas urdhër shpenzimeve, ndërsa po këto zëra pune paraqiten si të kryera nga mjetet e komunës fadroma dhe kamioni, sipas grafikut të punimeve për çdo muaj, të cilat janë nënshkruar nga komisioni i shërbimeve me vlera të

vogla, shoferi dhe kryetari i komunës, ku pa limit janë përfshirë nga 130-200 orë pune për çdo muaj për 3 vitet 2013-2015.

d. vlera **159,000 lekë**, shpenzime të pajustificuara për blerje goma automjetesh, sipas urdhër shpenzimit nr. 93, datë 22.6.2015, pasi gomat janë ndërruar para 4 muajve sipas urdhër shpenzimit nr. 231, datë 11.11.2014 pa normativë ligjore në harkun kohor 2013-2015.

e. vlera **200,000 lekë**, shpenzim i pajustificuar për pjese këmbimi për fadromën, sipas urdhër shpenzimit nr. 98, datë 22.6.2015, pasi ky lloj shpenzimi sapo është blerë sipas urdhër shpenzimit nr. 92, datë 22.6.2015 dhe nuk cilësohet fadroma e vjetra apo e sapo blera.

h. vlera **42,000 lekë**, për dieta të tepërta, sipas urdhër shpenzimit nr. 208, datë 15.10.2014 në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjëset që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit”.

i. vlera **1,078,537 lekë**, për punë të pakryer nga subjekti “N...” shpk, sipas urdhër shpenzimeve nr. 224, datë 21.10.2014, nr. 254 datë 15.12.2014, nr. 40 dhe 41, datë 25.3.2015, nr. 78, date 28.5.2015 etj, në kundërshtim me kërkesat e nenit 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

j. vlera **235,000 lekë**, tatim në burim, sipas urdhër shpenzimit nr. 135, datë 17.7.2014, në kundërshtim me VKM nr. 1149, datë 25.11.2009 “Për shtypjen dhe shpërndarjen e dokumentit tatimor”, me UMF nr. 52, datë 28.12.2009 ndryshuar me udhëzimin nr. 2, datë 7.01.2011, me ligjin nr. 8438, datë 28.11.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, ndryshuar nr. 8711, datë 15.12.2000 dhe ligjin nr. 8841, datë 11.12.2001.

l. vlera **613,082 lekë**, për shpenzime karburanti të pa justifikuara në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin”.

m. U konstatua **konflikt interesi** në 2 raste në komunën Kukur, për **302,400 lekë**, konkretisht:
- L. Z., specialist dhe kryeplak fshati, ka përfituar vlerën 151,200 lekë, për vitin 2013-korrik 2015.

- H. Q., përgjegjës shërbimesh dhe kryeplak fshati, ka përfituar vlerën 151,200 lekë për vitin 2013-korrik 2015, veprime në papajtueshmëri të funksionit të kryeplakut, në kundërshtim me ligjin nr. 8652 datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” ndryshuar me ligjin 139/2015 dhe me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

6.1. Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës **3,896,889 lekë dëm ekonomik**, përkatësisht:

a. vlerën **111,173 lekë**, ndaj subjektit “K...” shpk.

b. vlerën **252,100 lekë**, ndaj pjesëmarrësve sipas listës në komunë.

c. vlerën **945,597 lekë**, nga 135,085 secili, ndaj: L. Z., P. S., K. T., H. Q., Ç. L., H. M., L. K..

d. vlerën **159,000 lekë**, ndaj kryetarit të komunës, financierit dhe komisionit të blerjeve vogla.

e. vlerën **200,000 lekë**, nga 33,3333 lekë secili, ndaj: L. K., Ç. L., L. Z., P. S., K. T., H. Q..

h. vlerën **42,000 lekë**, për dieta përfituar tepër nga L. K. 20,000 lekë, C. L. 14,000 lekë, H. M. 5,000 lekë dhe M. S. 3000 lekë.

i. vlerën **1,078,537 lekë**, ndaj subjekti “N...” shpk.

j. vlerën **235,000 lekë**, tatim në burim, ndaj F. T.

l. vlerën **613,082 lekë**, nga 87,583 lekë secili, ndaj: L. K., C. L., P. S., H. Q., B. K. dhe H. M..

m. vlerën **302,400 lekë**, për L. Z. 151,200 lekë dhe H. Q. 151,200 lekë.

Brenda muajit Gusht 2017

7. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Gramsh, u konstatua se janë paguar 17 këshilltarë, të cilët nuk kanë frekuentuar mbledhjet e këshillit, si pasojë kanë përfituar në mënyrë jo ligjore shpërblimin për vlerën **941,565 lekë dëm ekonomik**, përkatësisht 754,350 lekë për periudhën 2013-korrik 2015 dhe 187,215 lekë për periudhën 01.07.2015-31.12.2016.

7.1. Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës **941,565 lekë**, ndaj 17 anëtarëve të KB të paguar pa marrë pjesë në mbledhjet (*sipas pasqyrës në raportin e auditimit*).

Brenda muajit Shtator 2017

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës të prokurimit me objekt “*Sistemim i bllokut të banimit lagjen “Sporti 2”*” **Bashkia Gramsh** për vitin 2016, rezultoi vlera **340,000 lekë dëm ekonomik**, pasi në preventivin e subjektit fitues BOE fitues “B...” shpk, zërat “Pajisje për lodra fëmijësh” subjekti i ka llogaritur me gjithë vlerën e tvsh, në mospërputhje me UKM nr. 2, datë 08.05.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, nuk është ndarë veças vlera e “montimit” të pajisjeve pa tvsh dhe veças vlera e “pajisjeve” me gjithë vlerën e tvsh dhe vihet në fund të situacionit, për rrjedhojë tvsh është përfituar 2 herë. Pajisjet për lodra fëmijësh pasqyrohen për vlerën 2,040,000 lekë.

8.1.Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës **340,000 lekë** ndaj subjektit BOE “B...” shpk, pasi subjekti në preventivin e tij zërat “Pajisje për lodra fëmijësh” i ka llogaritur me gjithë vlerën e tvsh, në mospërputhje me UKM nr. 2, datë 08.05.2003, nuk është ndarë veças vlera e “montimit” të pajisjeve pa tvsh dhe veças vlera e “pajisjeve” me gjithë vlerën e tvsh dhe vihet në fund të situacionit, për rrjedhojë tvsh është përfituar 2 herë.

Brenda muajit Qershor 2017

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës të prokurimit me objekt “*Blerje Fadrome për Drejtorinë e mirëmbajtjes së rrugëve rurale*”, **Bashkia Gramsh** rezultoi me shkelje në kualifikimin dhe vlerësimin OE fitues “R...” shpk, me pasojë **dëm ekonomik** në vlerën **1,780,300 lekë**, si diferencë nga përlllogaritjet, pasi çmimi i blerjes së fadromës tip Fiat HITAÇI është 2-3 fish më i lartë prej 5,885,472 lekë nga vlera reale e saj prej 13,000 euro (1,800,000 lekë), sipas dokumentit të origjinës (doganës) datë 30.12.2016. Vlerësimi i ofertave nuk është bërë mbi baza teknike dhe ekonomike, pasi çmimi i blerjes së fadromës nuk është real, nuk shpreh vlerën e mjetit me treguesit dhe parametrat teknik që disponon, pasi mjeti nuk është sipas specifikimeve teknike, është markë që nuk përcaktohet në procedurën e prokurimit, nuk ka pirun për ngritjen e materialeve ndryshme dhe nuk ka dokument për orët e punës. KVO ka gjykuar vlerësimin e mjetit nën mungesën fizike të saj dhe dokumentave, pasi OE nuk ka certifikatë pronësie për mjetin në fazën e konkurrimit. KVO ndryshimin e kritereve të kualifikimit në fazën e dytë nuk e ka shoqëruar me ndryshimin dhe uljen e çmimit të fadromës, pasi mjeti fadromë është me fuqi motorike më të ulët prej 5 kf dhe 4 vjet më i vjetërsuar nga ai i vitit 2004 që ishte në procedurën e parë, për pasojë nga këto veprime nuk është përmbushur qëllimin kryesor i nenit 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar.

9.1.Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës **2,071,000 lekë**, përkatësisht:

- vlerën **1,780,300 lekë**, nga 161,846 lekë secili, ndaj: E. Xh., E. K., Q. P., A.B., A. Sh., A. Ç., A. Sh., A. R., P. Z., A. H. Dhe L. D.

- vlerën **290,700 lekë** ndaj subjektit “R...”, për shitjen e Fadromës tip Fiat HITAÇI me

ndryshime në specifikimet teknike ndryshe nga ato të nënshkruara nga vetë subjekti.

Brenda vitit 2017

10. Gjetje nga auditimi: Nga ish-komuna Kodovjat janë kryer shpenzime për karburant, ku evidentimi i lëvizjes, menaxhimit dhe konsumit të karburantit nga automjeti tip “Fadromë” është bërë mbi bazën e një dokumentacioni mbështetës të parregullt, të pa plotë dhe të paqartë si dhe në mungesë të dokumenteve të tjera vërtetuese dhe plotësuese për punën e kryer. Nuk ka argumentim të rritjes së konsumit të karburantit në 6-mujorin e parë të vitit 2015 mbi limitin e harxhimit deri në 750 litra të aplikuar në vitin 2014 e të miratuar në vitin 2013. Këto procedura të ndjekura kanë shkaktuar efekt financiar në vlerën **864,716 lekë dëm ekonomik** në kundërshtim me nenin 4/26 të ligjit nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe me pikat 35, 36 dhe 37 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin asetëve në sektorin publik” i ndryshuar.

10.1.Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës **864,716 lekë** përkatësit: 432,358 lekë ndaj A. Ç., 216,179 lekë ndaj B.Z. dhe 216,179 lekë ndaj N. B.

Brenda muajit Qershor 2017

11.Gjetje nga Auditimi: Nga ish-komuna Tunjë janë kryer pagesa:

a. me urdhër-shpenzimin nr. 3 datë 11.01.2013 në shumën 99,000 lekë për shpërblim në fund të vitit 2012 të 11 punonjësve Administratës në masën 10,000 lekë për secilin në kundërshtim me VKM nr. 849, datë 06.12.2012 “Për një ndryshim në vendimin nr. 929, datë 17.11.2010 të këshillit të ministrave “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar pika 1, me pasojë shumën **99,000 lekë dëm ekonomik**.

b. për blerje karta për telefoninë celulare për përdorim nga ish-Kryetari i Komunës Tunjë, në kundërshtim me pikën 9 dhe 11 të VKM nr. 864, datë 23.7.2010 “Për Pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë”, me pasojë shumën **183,000 lekë dëm ekonomik**.

11.1.Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës 282,000 lekë:

-vlerën **99,000 lekë** ndaj personave sipas tabelës në raportin e auditimit.

-vlerën **183,000 lekë** ndaj R. B..

Brenda muajit Qershor 2017

12. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Gramsh janë kryer procedurat e konkurrimit për dhënie me qira të objekteve pronë e Bashkisë në 2 raste si dhe janë lidhur:

a. Kontrata nr. 815 Rep., nr. 321 Kol., datë 12.08.2013 me subjektin “...”, për dhënie me qira të pasurisë nr. 10/179, me sipërfaqe ndërtimi 2440 m² dhe truall funksional 3481 m² të ndodhur në Zonën kadastrale nr.1842, rezulton se nuk është kryer pagesa e qirasë për 40 muaj, deri në zgjidhjen e njëanshme të kontratës nga ana e Bashkisë me datë 05.09.2016, duke shkaktuar dëmin ekonomik në vlerën **12,544,800 lekë**.

b. Kontrata nr. 347 Rep., nr. 158 Kol., datë 05.03.2015 me subjektin “...”, për dhënie enfitozë të objektit “Repartit të Stampimit, ndodhur në ish-Uzinën e Pilave” godinë me sipërfaqe 817 m² dhe truallit të funksional 3270 m², rezulton se nuk është kryer pagesa e qirasë për 24 muajore është në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” Kreu I, pika 4, Kreu IV pika 1, Kreu VI pika 2/c,4 dhe me nenin 6.2 të kontratës, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën **2,760,000 lekë**.

12.1.Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat ligjore

për arkëtimin e vlerës **15,304,800 lekë** përkatësisht:

- vlerën 12,544,800 lekë ndaj subjekti “B...”,
- vlerën 2,760,000 lekë ndaj subjektit “K...”.

Brenda muajit Shtator 2017

13. Gjetje nga auditimi: Nga **Bashkia Gramsh** në vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016 ka lidhur 150 kontrata për dhënie me qira të një sipërfaqeje ndërtimore prej 11,251 m² të objekteve në pronësi të saj për banim dhe aktivitet biznesi, me afat kohor 1 vjeçar të ripërsëritura. Nga verifikimi i arkëtimeve për periudhën 2013-2016 rezultoi se, nuk kanë likuiduar detyrimet kontraktore 46 subjekte private, në kundërshtim me nenin 5 të kontratave, me VKM nr. 529, datë 8.6.2011 dhe me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” **duke shkaktuar dëmin ekonomik në vlerën 5,760,655 lekë.**

13.1.Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës **5,760,655 lekë** ndaj subjekteve qiramarrëse (sipas tabelës të paraqitur në Raportin Përfundimtar të Auditimit).

Brenda vitit 2017

14. Gjetje nga auditimi: Nga **Bashkia Gramsh** që nga viti 2000 janë lidhur kontrata për qira trualli me subjektet që i kanë zaptuar dhe i kanë në përdorim.

a. Për vitet 2000-2010 rezultojnë 17 subjekte debitorë, të cilët nuk kanë shlyer detyrimet kontraktore duke shkaktuar dëmin ekonomik në shumën **1,293,253 lekë.**

b. Për periudhën 2011-2014 rezultojnë 94 subjekte debitorë, të cilët nuk kanë shlyer detyrimet kontraktore duke shkaktuar dëmin ekonomik në vlerën **4,571,288 lekë.**

14.1.Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **5,864,541 lekë** nga subjektet qiramarrëse, sipas tabelave të paraqitura në Raportin e Auditimit, shumë kjo që i përket detyrimeve kontraktore të pashlyera nga këto persona.

Brenda vitit 2017

15. Gjetje nga auditimi: Nga **ish-komuna Lenie** janë lidhur 5 kontrata për dhënie me qira të parcelave nga fondi pyjor-kullësor, pa marrë miratimin paraprak të Drejtorisë të Shërbimit Pyjor Gramsh në kundërshtim me pikën 6 të VKM nr. 22, datë 9.1.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të administrimit të pyllit komunal”.

- 4 kontrata janë përcaktuar gabim tarifat e qirasë me diferencë në vlerën 95,200 lekë si dhe në 2 raste nuk janë paguar detyrimet kontraktore në shumën 72,000 lekë në kundërshtim me VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave” lidhja nr. 2 pika 1/1 dhe me VKM nr. 1064 datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën **167,200 lekë** në total.

15.1.Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **167,200 lekë**, ndaj: - vlerën 14,600 lekë B. B., - vlerën 14,600 lekë M. M., - vlerën 18,000 lekë A. T., vlerën 96,000 lekë L. S. dhe vlerën 24,000 lekë subjektit “V...”.

Brenda muajit Shtator 2017

16. Gjetje nga auditimi: Nga **ish-komuna Lenie** dhe **ish-komuna Kodovjat** janë lidhur kontrata qiraje me nr. 355 datë 17.03.2010 dhe me nr. 15 datë 17.03.2015 për dhënie në përdorim të parcelave të fondit pyjor për ndërtim e vendosje të stacionit nga “A...”. Nga Shoqëria “A...” sot “T...” nuk janë shlyer detyrimet kontraktore për të dy kontratat për vitet

2014-2015-2016, në kundërshtim me nenin 5 të kontratave dhe me pikat 1, 3/c, 4/h, 5, 11, 19, 21 dhe 24/d të UKM nr. 4, datë 22.4.2013 “Për përcaktimin e kritereve të konkurrimit dhe procedurën e dhënies në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullor publik”, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën **976,000 lekë**.

16.1.Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **976,000 lekë** ndaj subjektit “T...”.

Brenda muajit Shtator 2017

17. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumenteve financiare të derdhjes së tarifës së qirasë në ish-Komunat Skënderbegas, Kukur, Lenie dhe Kodovjat, rezultoi se deri më datë 31.12.2016 nuk janë likuiduar detyrimet kontraktore nga 7 fermerë, në kundërshtim me nenin 5 të kontratës, **duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 132,302 lekë**.

17.1.Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **132,302 lekë** ndaj fermerëve (sipas tabelës të paraqitur në Raportin Përfundimtar të Auditimit).

Brenda muajit Qershor 2017

18. Gjetje nga auditimi: Nga ish-Komuna Kodovjat janë lidhur kontrata për dhënie me qira në 27 raste të objekteve të zaptuara nga privatë për sipërfaqe totale 1399 m², nga verifikimi arkëtimeve rezultoi se, nuk janë shlyer detyrimet kontraktuale në 19 raste në vlerën 1,073,910 lekë në kundërshtim me nenet 5 dhe 7 të kontratave të lidhura, pikën 2/c me VKM nr. 529, datë 8.6.2011 dhe VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, **duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 1,073,910 lekë**.

18.1.Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **1,073,910 lekë** ndaj subjektet qiramarrëse (sipas tabelës të paraqitur në Raportin Përfundimtar të Auditimit).

Brenda vitit 2017

19. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Rikonstruksioni i Fasadave dhe i sheshit qendror të Qytetit” Gramsh, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca në volume **pune të pakryera** në vlerën **1,373,607 lekë** pa tvsh si pasojë e likuidimit të zërave të punimeve të pa kryer në fakt si prej përfshirjes së t.v.sh – së pajisjeve, në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1573 prot., datë 06.08.2015 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Gramsh dhe OE “N...” sh.p.k.

19.1. Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **1,373,607 lekë pa t.v.sh** ndaj operatori ekonomik “N...”.

Brenda muajit Qershor 2017

20. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Ndërtim KUZ Fshati Cekin lagja Jugore + pjesërisht lagja Veriore” Gramsh, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca në volume **pune të pakryera** në vlerën **4,765,938 lekë** pa tvsh si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 178 prot., datë 12.03.2013 të lidhur midis ish-Titullarit të Autoritetit Kontraktor Komuna Pishaj dhe BOE “D...”, kontratën e mbikëqyrjes së punimeve neni 1 dhe neni 2 si dhe me kontratën e kolaudimit të punimeve.

20.1. Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative

e ligjore për arkëtimin e vlerës **4,765,938 lekë** pa tvsh ndaj BOE “D...”.

Brenda muajit Qershor 2017

21. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Ndërtim Ura tip Bailey mbi lumin Kushovë*” Gramsh, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume **pune të pakryera** në vlerën **110,000 lekë** pa tvsh si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 180/3 prot., datë 19.08.2014 të lidhur midis ish-Titullarit të Autoritetit Kontraktor Komuna Kushovë dhe BOE “P...”, kontratën e mbikëqyrjes së punimeve datë 19.08.2014 neni 1 dhe neni 2, kontratën e kolaudimit të punimeve datë 06.10.2014 neni 1 dhe neni 2.

21.1. Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **110,000 lekë** pa tvsh ndaj BOE “P...”.

Brenda muajit Qershor 2017

22. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Ndërtim i urës tip Bailey në lumin Kukur, fshati Grazhdan*” Gramsh, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume **pune të pakryera** në vlerën **271,330 lekë** pa tvsh si pasojë e mos ndryshimit të zërave të situacionit sipas punimeve të kryera në fakt si dhe mos aplikim i penalitetit për vonesa në përfundimin e punimeve në vlerën **104,750 lekë** pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2497 prot., datë 21.04.2016 të lidhur midis Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Gramsh dhe BOE “P...”, kontratën e mbikëqyrjes së punimeve nr. 2731 prot., datë 04.05.2016.

22.1. Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **271,330 lekë** pa tvsh ndaj BOE “P...”.

22.2. Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **104,750 lekë** pa tvsh ndaj BOE “P...”.

Brenda muajit Qershor 2017

23. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Zbatim i projektit emergjent për ndërtimin e urës tip Bailey në përroin e Terpes dhe rikonstrukcion i rrugës Siman - Përroi i Terpes*” Gramsh, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume **pune të pakryera** në vlerën **115,900 lekë** pa tvsh si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 754 prot., datë 17.10.2014 të lidhur mes ish-Titullarit të Autoritetit Kontraktor Komuna Skëndërbegas dhe OE “P...”, kontratën e mbikëqyrjes së punimeve nr. 752 prot., datë 17.10.2014 (*Trajtuar në faqet 143-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

23.1. Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **115,900 lekë** pa t.v.sh ndaj OE “P...”.

Brenda muajit Qershor 2017

B/1. SHPENZIME ME EFEKT FINANCIAR NEGATIV NË BUXHETIN E BASHKISË

1. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2013-2014 në **Bashkinë Gramsh** janë kryer në 5 raste shpenzime për transportin e nxënësve të dalluar në qytete të ndryshme të Shqipërisë në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që

dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” i ndryshuar pika VII, **me pasojë efektin financiar negativ për buxhetin e Bashkisë në shumën 407,000 lekë.**

1.1.Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masa, që në të ardhmen të mos kryejë shpenzime në lidhje me udhëtimin dhe akomodimin e nxënësve të shkollave në aktivitete si ekskursionet, ekspedita apo shpenzime të tjera të karakterit didaktik e mësimor, pasi nuk është pjesë e funksioneve të saj.

Në Vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga **Bashkia Gramsh** për periudhën 2013-2016 janë kryer pagesa për shpenzime për furnizimin me energji elektrike në bazë të faturave tatimore të lëshuara nga furnitori OSHEE, i cili në faturimet e tij për harxhimin e energjisë ka shtuar si zë shpenzimi *taksën e televizorit* edhe për linjat e ndriçimit rrugor e të stacioneve të ujit të pijshëm të administruara nga Bashkia Gramsh në kundërshtim me ligjin nr. 10296, date 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 9/pika 4, neni 12 pika 3, **duke rritur shpenzimet me një efekt financiar negativ në shumën 129,600 lekë.** Për këtë mbi faturim nga Bashkia nuk ka korrespondencë zyrtare me OSHEE dhe nuk është ndjekur në rrugë administrative dhe gjyqësore ky problem, duke mos i dhënë zgjidhje në kundërshtim me ligjin 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil ne Republikën e Shqipërisë” neni 420 dhe 693 dhe me kontratat e lidhura.

2.1.Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masa që të ndjekë në rrugë administrative dhe gjyqësore kërkimin e kthimit të vlerës **129,600 lekë** të mbi faturuar nga OSHEE.

Në Vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga **ish-Komuna Kodovjat** me urdhër-shpenzimin nr. 82 datë 22.04.2013 është kryer pagesë në shumën 250,000 lekë për shpenzime për pritje përcjellje, për rastin e inaugurimit të rrugës Gramsh-Kodovjat në kundërshtim me VKM nr. 243 datë 15.05.1995 “Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja” të ndryshuar me VKM nr. 258 datë 3.6.1999 dhe pikat 35, 36 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, **me pasojë efektin financiar negativ për buxhetin e ish-Komunës në shumën 250,000 lekë.**

3.1.Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masa, që në të ardhmen të mos kryejë shpenzime për pritje e përcjellje për komunitetin vendas e autoritete, pasi për shpenzimet e këtij lloji mungon baza ligjore.

Në Vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Për vitet 2012-2015 është kryer privatizimi i 62 banesave në pronësi të bashkisë, për sipërfaqeje ndërtimore prej 4629.8 m² në vlerën 12,652,810 lekë, objekte të vendosura në 11 objekte të ish-ndërmarrjeve dhe ish-institucioneve. Procedurat e Privatizimeve janë realizuar në bazë të VKB nr. 32 dhe nr. 33 datë 18.05.2012, nr. 24 datë 03.06.2014 dhe nr. 31 datë 18.07.2014 “Për kalimin në fond banese të objekteve në pronësi të Bashkisë Gramsh për nevoja strehimi”. Vendimmarrja e Këshillit Bashkia është kryer mbi baza ligjore të gabuara, që nuk përkon me rastet e propozuara për miratim, pasi objektet e privatizuara kanë qenë të zaptuara nga përfituesit aktual. Objektet nuk kanë qenë shndërruar në objekte banimi dhe nuk kanë kaluar në fond banese të EKB, si dhe për privatizim e tyre nuk janë ndjekur procedurat dhe kriteret sipas ligjit nr. 9232, datë 13.05.2004 “Për programeve sociale të strehimit të banorëve të zonave urbane” të ndryshuar, neni 39/1, VKM nr. 97 datë 03.02.2008 “Për procedurat e privatizimit të banesave, objekt i ligjit nr. 7652 datë 23.12.1992”, njëherazi bashkia nuk ka është bazuar në çmimet e referencës të miratuara nga EKB në përcaktimin e vlerës së privatizimit, duke sjellë një efekt financiar negativ në të

ardhurat e Bashkisë Gramsh në shumën prej 137,250,854 lekë.

- Nga **ish-Komuna Kodovjat** është kryer privatizimi i 11 banesave me sipërfaqe 477 m², në vlerën 1,796,265.3 lekë, sipas vendimit të këshillit Komunës nr. 30 datë 21.11.2014 “Për kalimin në fond banese të objekteve në pronësi të Komunës Kodovjat për nevoja strehimi”.

Për objektet e privatizuara ish-komuna ka ndjekur të njëjtën procedurë si Bashkia Gramsh, duke sjellë arkëtimin më pak nga privatizimi, me efekt financiar negativ në të ardhurat në shumën prej **13,627,530 lekë**.

4.1.Rekomandim: Bashkia Gramsh t’i propozojë Këshillit Bashkiak shfuqizimin e VKB nr. 18 dhe nr. 19 të datës 16.03.2015 “Për kalimin në fond banese të objekteve në pronësi të Bashkisë Gramsh për nevoja strehimi”, të cilat nuk kanë gjetur zbatim, pasi nuk janë konfirmuar për pajtueshmëri ligjore nga Prefektura e Qarkut Elbasan. Në rastet e tjera të tjetërsimeve dhe shitjeve të pronave të Bashkisë të bëhen me procedurë konkurrimi dhe me çmime tregu, ndërsa për banim me çmimet e referencës të EKB të miratuara me UKM sipas viteve përkatëse, kur bëhen privatizimet. Lidhur me politikat sociale për strehim Bashkia të marrë masa për hartimin e programeve sociale për strehim, të hartojë kriteret e përfitimit sipas dispozitave ligjore në fuqi për këtë qëllim dhe të ngrejë komisione për vlerësimin e kërkesave sipas këtyre kritereve për përfitimin nga këto programe.

Brenda muajit Korrik 2017

C. MASA DISIPLINORE

C.1. Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.

Mbështetur në nenin 58 “llojet e masave disiplinore” shkronja “b” të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe nenin 64 shkronjat **g** dhe **k** të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë, që ti kërkojë Komisionit disiplinor të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore si më poshtë:

“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në 2 vjet, për:

1. z. A. Sh., me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, për veprime dhe mosveprime në papajtueshmëri me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi gjatë ushtrimit të funksionit të Drejtorit Juridik për periudhën 2012-Tetor 2013.

2. z. E. K., me detyrë Drejtor Juridik dhe Shërbimeve Mbështetëse Bashkia Gramsh, për veprime dhe mosveprime në papajtueshmëri me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi gjatë ushtrimit të funksionit të anëtarit të KVO-së dhe Drejtorit të DRSHM-së.

3. z. A. Sh., me detyrë përgjegjës finance komuna Porocan, për veprime dhe mosveprime në papajtueshmëri me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi gjatë ushtrimit të funksionit të nëpunësit zbatues dhe në Kryetarit të KPVV për periudhën 01.02.2013-30.06.2015.

4. z. H. Ll., me detyrë Administrator i Njësisë Administrative Porocan, për veprime dhe mosveprime në papajtueshmëri me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi gjatë ushtrimit të funksionit të ish-kryetar Komunës Porocan.

“Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj, për:

5. z. A. B. me detyrë Drejtor Finance Bashkia Gramsh, për veprime dhe mosveprime në

papajtueshmëri me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi gjatë ushtrimit të funksionit nëpunësit zbatues.

6. z. A. C. me detyrë Drejtor i Planifikimit të Territorit Bashkia Gramsh, për veprime dhe mosveprime në papajtueshmëri me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi gjatë ushtrimit të funksionit të anëtarit të njësisë së monitorimit të kontratave të qiradhënies, të hartuesit të relacionit paraprak dhe anëtarit të komisionit të zbatimit të procedurës së privatizimit.

7. z. Y. K., me detyrë Inspektor sipërmarrje në Drejtorinë e Shërbimeve, për veprime dhe mosveprime në papajtueshmëri me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi gjatë ushtrimit të funksionit të anëtarit të KPVV Bashkia Gramsh.

C.2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas Kodit Punës.

Mbështetur në shkronjën (c) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë** të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave si më poshtë:

“**Vërejtje**”¹, për 2 punonjës:

8. z. E. Q., me detyrë N/Kryetar Bashkie, për veprime dhe mosveprime në papajtueshmëri me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi gjatë ushtrimit të funksionit të Kryetarit të KVO.

9. zj. Dh. Ç., me detyrë specialiste e sektorit të menaxhimit të Aseteve Vendore Bashkia Gramsh, për veprime dhe mosveprime në papajtueshmëri me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

“**Vërejtje**”, për 9 punonjës:

10. z. S. L., me detyrë përgjegjës i qendrës së kulturës Bashkia Gramsh.

11. zj. L. T. me detyrë specialiste buxheti e inventarizuese në Drejtorinë e Financës në cilësinë e anëtarit të KPVV Bashkia Gramsh.

12. zj. V. Z. me detyrë arkëtare, në cilësinë e antarit të KPVV Bashkia Gramsh.

13. zj. V. B., me detyrë përgjegjëse finance Komuna Kodovjat, në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe në cilësinë e kryetares së KPVV.

14. z. K. T., me detyrë administrator i ndihmës ekonomike komuna Kodovjat në cilësinë e anëtarit të KPVV.

15. z. G. P., me detyrë specialist i Ndihmës Ekonomike Komunës Porocan.

16. z. D. B., me detyrë administrator i ndihmës ekonomike Komuna Tunjë, në cilësinë e anëtarit të KPVV.

17. z. Sh. L., me detyrë inspektor i shërbimeve Publike Komuna Tunjë, në cilësinë e anëtarit të KPVV.

18. z. B. Xh., me detyrë ish-sekretar këshilli dhe përgjegjës i zyrës juridike- magazinë Komuna Lenie.

D. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL:

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër (Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit), pasi të zbatohet procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë**

¹ Lloji i masës disiplinore është ndryshuar me Vendimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, nr.55 datë 19.05.2017.

veprimet si më poshtë:

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.
2. Të njoftoj Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.

E. MASA ADMINISTRATIVE

E.1. Për Agjencinë e Prokurimit Publik (APP)

I. Referuar parregullsi dhe shkeljeve të ndryshme të konstatuara në procedurat e prokurimeve me vlerë të lartë për periudhën 01.01.2012 deri më 31.12.2016, si dhe përgjegjësisë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative" dhe bazuar në nenin 15 shkronja (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara**, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimeve publike, apo rekomandimin e Autoritetit Kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), ndaj **30 punonjësve për 17 procedura prokurimi**, si më poshtë:

I. Për Bashkinë Gramsh, 15 punonjës, për shkelje dhe parregullsi në procedurat e prokurimit të realizuara, *konkretisht*:

1. **z. D. B.**, me detyrë ish-Kryetar i Bashkisë, në cilësinë e Titullarit të AK, në 3 procedura prokurimi.
2. **zj. L. D.**, me detyrë Kryetare e Bashkisë, në cilësinë e Titullares të AK, në 2 procedura prokurimi.
3. **z. E. Q.**, me detyrë nën-kryetar i Bashkisë Gramsh, në cilësinë e kryetarit të KVO, në 3 procedura prokurimi.
4. **z. I. H.**, në cilësinë e anëtarit të KVO, në 3 procedura prokurimi.
5. **zj. M. Ç.**, Kryeinspektor IMTV, në cilësinë e anëtares të KVO, në 3 procedura prokurimi.
6. **z. K. F.**, në cilësinë e anëtarit të KVO Bashkisë Gramsh, në 2 procedura prokurimi.
7. **zj. E. I.**, inspektore IMTV Bashkisë Gramsh, në cilësinë e anëtarit të KVO dhe në cilësinë e antarit të NJP, në 4 procedura prokurimi
8. **z. E. K.**, me detyrë jurist, në cilësinë e anëtarit të NJP, në 4 procedura prokurimi.
9. **Z. Q. P.**, me detyrë Drejtor i Shërbimeve, në cilësinë e anëtarit të NJP, në 4 procedura prokurimi.
10. **z. Y. K.**, me detyrë supervisor pastrimi, në cilësinë e anëtarit të NJP, në 1 procedurë prokurimi.
11. **z. A. R.**, me detyrë specialist i urbanistikës në Bashkinë Gramsh, në cilësinë e anëtarit të NJP, në 1 procedurë prokurimi.
12. **z. A. Sh.**, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë, në cilësinë e anëtarit të KVO të Bashkisë Gramsh, anëtarit të NJP në ish-komunat Skënderbegas dhe Kukur, në 3 procedura prokurimi.
13. **z. A. Sh.**, me detyrë specialist në cilësinë e anëtarit të KVO, për shkelje në 1 tender.

14. z. A. C., me detyrë Drejtor i Urbanistikës Bashkisë Gramsh, në cilësinë e anëtarit të KVO për shkelje në 3 procedura prokurimi.

15. z. Dh. N., me detyrë Specialist ne DPTZH Bashkia Gramsh, në cilësinë e anëtarit të NJHDT, në 1 procedurë prokurimi.

II. Për ish- Komunën Skënderbegas, për 7 punonjës, për shkelje dhe parregullsi në procedurat e prokurimit të realizuara, *konkretisht:*

1.16. z. H. P., me detyrë ish-Kryetar i Komunës Skënderbegas, në cilësinë e Titullarit të AK.

2.17. z. A. H., me detyrë financier i Komunës, në cilësinë e anëtarit të NJP, në 2 procedura prokurimi dhe në cilësinë e kryetarit të KVO, në 1 procedurë prokurimi.

3.18. z. K. Z., inxhinier i Komunës, në cilësinë e anëtarit të NJP, në 3 procedura prokurimi.

4.19. zj. I. (S.) N., me detyrë juriste, në cilësinë e anëtares të NJP, në 2 procedura prokurimi.

5.20. z. H. M., në cilësinë e anëtarit të KVO, në 2 procedura prokurimi.

6.21. z. Ç. Ç., në cilësinë e antarit të KVO, në 3 procedura prokurimi.

7.22. z. G. P., në cilësinë e antarit të KVO, në 2 procedura prokurimi.

III. Për ish- Komunën Kukur, për 6 punonjës, për shkelje dhe parregullsi në procedurat e prokurimit të realizuara, *konkretisht:*

1.23. z. L. K., me detyrë Kryetar i Komunës Kukur, në cilësinë e Titullarit të AK,

2.24. z. L. Z., në cilësinë e anëtarit të NJP,

3.25. z. N. V., në cilësinë e anëtarit të NJP,

4.26. z. N. K., në cilësinë e anëtarit të KVO,

5.27. z. Ç. L., në cilësinë e anëtarit të KVO,

6.28. z. M. S., në cilësinë e anëtarit të KVO.

(VO: Në mënyrë të hollësishme shkeljet për 6 punonjësit e mësipërm në 3 procedurë prokurimi të zhvilluara nga ish-Komuna Kukur paraqiten në ANEKSI Nr. 3, bashkëlidhur këtij Vendimi).

IV. Për ish- Komunën Kodovjat për 6 punonjës, për shkelje dhe parregullsi në procedurat e prokurimit të realizuara, *konkretisht:*

1.29. z. A. Ç., me detyrë ish-kryetar i komunës Kodovjat, në cilësinë e Titullarit të AK,

2.30. z. F. D., në cilësinë e anëtarit NJP,

3.31. zj. A. F., në cilësinë e anëtarit NJP,

3.32 zj. F. M., në cilësinë e anëtarit NJP,

4.33 z. A. B., në cilësinë e kryetares së KVO,

5.34. z. B. Z., në cilësinë e anëtarit të KVO,

6.35. z. N. L., në cilësinë e anëtarit të KVO.

E.2. Për Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV)

Nga Bashkia Gramsh të merren masa që në mbështetje të ligjit nr. 8402 dt. 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, për shkelje të nenit 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16, t’i **kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor**, të vendosë masë administrative me gjobë për 5 mbikëqyrës punimesh dhe 1 kolaudator punimesh si më poshtë:

1. **Ing. D. Q., në vlerën 50,000 lekë,** për shkeljen e konstatuar me pasojë dëm ekonomik në vlerën 1,373,607 lekë pa tvsh nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin “Rikonstruksioni i Fasadave dhe i sheshit qendror të Qytetit” Gramsh;

2. **Ing. N. M., në vlerën 50,000 lekë,** për shkeljen e konstatuar me pasojë dëm ekonomik në vlerën 593,289 lekë pa tvsh nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin “Ndërtim dhe rikonstruksion i urave në rrugën automobilistike” Gramsh;

3. Ing. P. M., në vlerën 50,000 lekë, për shkeljen e konstatuar me pasojë dëm ekonomik në vlerën 376,080 lekë pa tvsh nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin “Ndërtim i urës tip Bailey në lumin Kukur, fshati Grazhdan” Gramsh;

4. Ing. T. S., në vlerën 200,000 lekë, për shkeljen e konstatuar me pasojë dëm ekonomik në vlerën 4,765,938 lekë pa tvsh nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin “Ndërtim KUZ Fshati Cekin lagja Jugore + pjesërisht lagja Veriore” Gramsh;

5. Ing. L. K., në vlerën 50,000 lekë, për shkeljen e konstatuar me pasojë dëm ekonomik në dy raste, nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektet:

1. “Ndërtim Ura tip Bailey mbi lumin Kushovë” Gramsh, vlera 110,000 lekë pa tvsh;

2. “Zbatim i projektit emergjent për ndërtimin e urës tip Bailey në përroin e Terpes dhe rikonstruksion i rrugës Siman - Përroi i Terpes”, Gramsh, vlera 115,900 lekë pa tvsh;

6. Ing. S. T., në vlerën 500,000 lekë, për shkeljen e konstatuar me pasojë dëm ekonomik në katër raste, nën cilësinë e kolaudatorit të punimeve në objektet:

1. “Rikonstruksioni i Fasadave dhe i sheshit qendror të Qytetit” Gramsh vlera 1,373,607 lekë;

2. “Ndërtim i urës tip Bailey në lumin Kukur, fshati Grazhdan” Gramsh vlera 376,080 lekë;

3. “Ndërtim KUZ Fshati Cekin lagja Jugore+pjesërisht lagja Veriore” Gramsh vlera 4,765,938 lekë pa tvsh;

4. “Zbatim i projektit emergjent për ndërtimin e urës tip Bailey në përroin e Terpes dhe rikonstruksion i rrugës Siman - Përroi i Terpes” Gramsh, vlera 115,900 lekë pa tvsh.

Sa sipër nga mbikëqyrësit e punimeve dhe kolaudatorët e mësipërm janë firmosur situacione me punime të pakryera në fakt, janë përfshirë në situacionin përfundimtar tvsh e pajisjeve si dhe nuk janë marrë masa për ndryshimin e zërave të situacioneve përfundimtare sipas punimeve zërave të punimeve të kryera në fakt, në kundërshtim me nenin 7 dhe 12 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin e KM nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” Kreu II, Pika 3, UKM nr. 2, datë 8.5.2003 “Për Klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, Kreu I/I “Klasifikimi i punimeve të ndërtimit”, germa “A”, paragrafi i fundit, UKM Nr. 1, datë 16.6.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pika 1, germa “c”, paragrafi i fundit, Kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1573 datë 06.08.2015 të lidhur mes ish Titullarit të Autoritetit Kontraktor dhe OE “N” sh.p.k si dhe kontratën e lidhur për shërbimin e mbikëqyrjes së punimeve, -Udhëzimi i KM nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu I, pika 7, Kreu II, pika 8.1 si dhe pika 8.3. Njëherazi veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratat përkatëse të sipërmarrjes si dhe atyre të lidhura për shërbimin e mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve.

E.3. Për Ministrinë e Zhvillimit Urban. (Heqjen e licencës profesionale)

Mbështetur në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, VKM nr. 759, datë 12.11.2014 “Për Licencimin Profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit” dhe në nenet 13, 25 dhe pika 1/a, 1/e, e nenit 41, Kreu VI-të, “Sanksione dhe Dispozita kalimtare”, të “Rregullore për Kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe subjekte juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit”, për shkelje të ligjshmërisë në zbatimin e punimeve, në fushën e

ndërtimit, *i rekomandojmë* Komisionit të Licencave, pranë Ministrisë të Zhvillimit Urban: **Heqjen e së drejtës për ushtrimin e aktivitetit ose pezullimin e përkohshëm në zbatim** (heqjen e Licencës profesionale), për një afat deri nga 2-3 vjet, për personat si më poshtë:

1. Ing. S. T. nën cilësinë e kolaudatorit të punimeve.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për objektin “Ndërtim KUZ Fshati Cekin lagja Jugore+pjesërisht lagja veriore” u konstatua se punimet në objekt janë kryer në bazë të kontratës për punë publike me nr. 178 prot., datë 12.03.2013 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor ish Komuna Pishaj dhe BOE me vlerë të kontratës 14,003,592 lekë me tvsh me afat zbatimit 60 ditë. Kolaudimi i punimeve të ndërtimit është kryer nga ing. Sofie Topuzi me nr. licence MK 0668/2 datë 07.05.2012. Sipas aktit me nr. 185/1 prot., datë 02.04.2013 është lidhur kontrata shtesë e sipërmarrjes për vlerën 2,641,476 lekë me tvsh, ose 18.8% e vlerës së kontratës bazë. Afati përfundimtar i zbatimit të kontratës është data 03.05.2013.

Nga verifikimi në terren, nga projekti i miratuar si dhe nga librezja e masave **nuk rezultoi asnjë gjurmë dokumentare dhe faktike në terren e realizimit të volumeve të punës për ato të situacionit përfundimtar të kontratës shtesë.** Të vetmet dokumente të cilat rezultuan në dosjen teknike për kontratën shtesë ishin vetë kontrata shtesë e sipërmarrjes së punimeve si dhe situacioni përfundimtar i pashoqëruar me librezë masash si dhe dokumentacionin shoqërues siç parashikon Udhëzimi nr. 3 datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar. Volumet e punës të paraqitura në situacionin përfundimtar të kontratës shtesë rezultuan të pakryera në masën 100 % të tyre edhe pse të likuiduara. Dëmi ekonomik i konstatuar në këtë investim publik është në vlerën **4,765,938** lekë pa tvsh.

-Nuk është zbatuar neni 12 i ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, nuk është zbatuar Kreu II, Pika 3 e Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, nuk është zbatuar pika 4, paragrafi 4 i Udhëzimit nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, nuk janë marrë masa për zbatimin e Kreu I, pika 3.2, 3.3 dhe pika 15, germa ç e Udhëzimit nr. 3 datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësisë të Qeverisjes Vendore dhe Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R